

## NDIKIMI I NGJARJES SË QERBELASË NË LETËRSI DHE NË ARTET E TJERA

Qerbelaja, që ndodhet 100 km në jugperëndim të Bagdatit, është vendi ku më 10 Muharrem të vitit 61 Hixhri, nipi i Profetit Muhamed (p.q.m.t), Hz. Hysejni, u martirizua duke u lënë pa ujë dhe kjo ngjarje e trishtë ka qenë burim dhimbjeje për shekuj me radhë.

Siç dihet, kjo ngjarje e dhimbshme mori shkas nga pretendimi që kishte Jezidi, i cili e shndërroi në mbretëri kalifatit duke e trashëguar nga i jati, që Hz. Hysejni t'i nënshtrohej me dhunë. Hz. Hysejni, që preferonte një jetë larg ngatërresave politike dhe që nuk iu nënshtroa Jezidit, ngaqë ky udhëhiqte dhe sillej në kundërshtim me Islamin, pas këmbënguljes së banorëve të Kufes, të cilët donin që të ishte kalif, u nis nga Medina për në Kufe. Por u detyrua të ndalej në Qerbela, ku nuk u la të përdorte ujin e Eufratit. Duke mos pasur tjetër mundësi, përveç luftës ose nënshtimit, u detyrua të luftonte. Pas martirizimit të 71 vetëve, ndërmjet të cilëve kishte edhe pjesëtarë të Ehl-i Bjetit (familjes së nderuar të Profetit p.q.m.t), Hz. Hysejni u martirizua duke iu prerë koka nga një goditje me shpatë prej Sinan Bin El-Nehaiut. Kjo ngjarje e dhembshme i ka prekur thellë të gjithë muslimanët dhe dhembja e saj ka ardhur duke u rritur ndër shekuj deri në ditët tona. Një ngjarje e tillë, që pati pasoja historike dhe sociale dhe që ka prekur thellë, është e pamundur të mos kishte ndikim në letërsi dhe në artet e bukura.

Përkujtimi në 10 Muharrem, ditës që ra dëshmor Hz. Hysejni, i kësaj ngjarjeje të trishtuar dhe konsiderimi i saj si ditë zie, me kalimin e kohës ka sjellë pasurimin e zakoneve, traditave dhe praktikave që kanë lidhje me të. Në kohën e sundimit të Byvejhinjve, të cilët kanë sunduar në rrethinat e Bagdatit në shekullin XI, filloi të përkujtohej martirizimi i Hz. Hysejnit me ceremoni që u ngjajnë ceremonive të mevludit në ditët tona. Edhe Mevlana (Rumi) në Mesnevinë e tij tregon se ndër arabë zhvilloheshin ceremoni të

tilla (të ngjashme me të).

Në Iran, me pranimin e shiizmit si sekt zyrtar në shekullin XIV, çdo vit përkujtohej ngjarja e Qerbelasë. Edhe ata që në dashurinë ndaj Hz. Aliut kanë kaluar në ekstremizëm, mbajnë të njëjtin qëndrim në lidhje me përkujtimin e kësaj ngjarjeje. Në Iran dhe vendet ku jetojnë shiitët, ngjarja e Qerbelasë përkujtohet me emrat *tazije* ose *shebeh* (ngushëllim për rast vdekjeje) dhe njerëzit që vënë kujën duke goditur e lënduar veten me zinxhirë e me gurë, besojnë se janë fajtorë ngaqë nuk i erdhën dot në ndihmë Hz. Hysejnit. Për dhjetë ditë me radhë mbajnë agjërime ujë. Përveç kësaj, gjatë këtyre ditëve njerëzit nuk shihen në pasqyrë, nuk lahen, nuk këndojnë, nuk vrasin gjë të gjallë dhe nuk rruhen. Lepuri nuk hahet, ngaqë besohet se shpirti i Jezidit është shndërruar në lepur. Një pjesë e shiitëve besojnë se kjo botë është e papastër, por dheu i Qerbelasë është i pastër, ngaqë këtu u derdh gjaku i Hz. Hysejnit. Për këtë arsye, gjatë namazit sexhdja duhet të bëhet mbi gurin e bërë nga ky **dhe**. Ibrahim Hakki Kemahiu, duke treguar se do ta pastrojë botën me lot, na flet për këtë besëtytni me vargjet e mëposhtme.

*“Kıyametler kopdu çok acayıpler olup zahir / Ndodhen gjëra të çuditshme, sikur të kish ardhur dita e kjametit*

*Selab-ı eşkile Hakki cihanı eyle tathir.” / Ej, Hakki, pastroje botën me lot.*

Ata që ndjekin një rrugë më të moderuar dhe mistikët mendojnë se ngjarja e Qerbelasë duhet të shihet si një fatkeqësi e kësaj bote dhe duhet të bëhet durim dhe në përkujtimin e 10 Muharremit janë treguar më të arsyeshëm. Mes zakoneve dhe praktikave në lidhje me këtë ngjarje mund të përmenden leximi i Kuranit, falja e namazit, bërja e lutjeve, gatimi dhe shpërndarja e ashures, leximi i mevludit, shpërndarja e ujit, mospirja e ujit me tepri etj.

Ngjarja e Qerbelasë ka lënë gjurmë edhe në gjuhën turke me krahasimet dhe shprehjet frazeologjike që na e sjellin ndër mend: Qerbelaja, që vjen si shenjë/tregues i thatësirës, përdoret si krahasim për vendet ku nuk ka ujë. Për këtë krahasim përdoret shprehja “Kerbela’ya dönme” (Me u bë Qerbela). Kurse Jezidi, që u bë shkaku i kësaj ngjarjeje, merret si shembull i keq krahasimi. Ngjarja nënkuptohet me shprehje si “*seni Yezid seni*” (ah, Jezid!) ose

“*Yezid tohumu*” (farë Jezidi), që përdoren për njerëzit që bëjnë keq.

Krahas traditës popullore, kjo ngjarje e dhembshme është pasqyruar edhe në arte të ndryshme. Tazijet ose shebehet që zhvillohen në kujtim të ngjarjes së Qerbelasë, janë një tip vepre teatrale që përbëjnë llojin e vetëm të dramës islame. Kurse *hysejnjiet* dhe *tekjet*, që u ndërtuan në Iran për inskenimin e tyre, janë pjesë e ndikimit të ngjarjes në aspektin arkitekturor. Më përpara ngjarja e Qerbelasë tregohet nga një aktor/interpretues i vetëm që quhej *meddah*, *nakkal*, *ruzehan* apo *perdedari*. Edhe pikturat/figurat që bëheshin mbi perden që vendosej pas interpretuesit, kishin lidhje me këtë temë. Gjatë tazijeve përdoren edhe kukullat. Gjashtë prej tyre ruhen në muzeun e Teatrit të Kukullave të Sergej Obzratsohut në Moskë. Ndër miniaturat më të rëndësishme në lidhje me këtë temë, të cilat hasen nëpër libra, mund të përmendim ato që ndodhen në kopjet e veprës “Hadikatu’s Sueda” të Fuzuliu të gjenden në British Museum, Türk-İslam Eserleri Müzesi (Muzeu i Veprave Turke-Islame), Süleymaniye Kitaplığı (Biblioteka e Sulejmanijes), Konya Mevlana Müzesi (Muzeu i Mevlanës në Konja), Koleksioni i Edwin Binney-t në Nju Jork, New York Brooklyn Museum, Paris Bibliotheque National dhe në Ankara Etnografya Müzesi (Muzeu Etnografik i Ankarasë), si dhe në kopjet e veprës “Maktel-i Imam Huseyin” të Lamii Çelebiut që gjenden në British Museum dhe në Türk-İslam Eserleri Müzesi (Muzeu i Veprave Turke-Islame).

*Mersijet* që këndoheshin në tonalitete (melodi) të ndryshme nëpër Tazije dhe Shebehe, apo në tjera shfaqje (aktivitete) në lidhje me ngjarjen e Qerbelasë, tregojnë se kjo ngjarje ka ndikuar edhe në muzikë (fushën e muzikës). Kënduesit e mersijeve quhen *mersijehan*. Ndër mersijehanët e Stambollit në shek. XVIII dhe XIX, që me këndimin e tyre prekës u bënë të njohur, përmenden: Turshuxhuzade Hafiz Mehmet Efendiu prej Kastamonu-je, Bedevi Shejhi Ali Babai, Hakki Beu prej Bejlerbeji, Hafiz Shrefeddin Efendiu, Hafiz Hamdi Efendiu dhe Hafiz Hysejin Tevfik Efendiu.

Ndër artet e bukura, fusha që më së shumti u ndikua nga ngjarja e Qerbelasë, është letërsia. Krahas futjes së ngjarjeve historike në letërsi, shkak tjetër i lëvrimit letrar në masë të kësaj ngjarjeje ishte edhe mendësia se përmendja dhe vajtimi për Al-i Abanë bëhej

shkak për faljen e gjynaheve, siç e përmend edhe Fuzuliu në këtë dyvargësh:

*“Yad it Fuzuli Al-i Aba halin eyle ah / Ej, Fuzuli, kujto gjendjen e familjes së Profetit dhe vajto*

*Kim berk-i ah ilen yakulur hirmen-i gunah”/ Pirgu i gjynaheve ndizet me shkëndijën e vajit.*

Kjo traditë e të shkruarit të Maktel-i Husejnit (Elegji për vrasjen e Hysejnit), që fillimet i ka në letërsinë arabe me veprën “Kitab-i Maktel-i Husejn’i” të Minhaf Lut Bin Jahja (?-774), shembullin më të mirë në letërsinë iraniane e ka me veprën “Ravzatu’sh-Shuheda” të Hysejin Vaiz Kashifit (?-1505) dhe që në letërsinë turke përfaqësohet me veprën “Hadikatu’s – Sueda” të Fuzuliu, u vazhdua nga një numër i madh poetësh.

Një aspekt i ndikimit të kësaj ngjarjeje në letërsi janë edhe mersijet (elegjitë) e Qerbelasë. Ky lloj letrar që zë vend në shumë vepra, duke filluar nga divanet, është lëvruar nga shumë poetë, që nga viti kur ndodhi e deri në ditët e sotme. Sikurse dihet, mersija është poezi lirike e letërsisë së divanit, ku pas vdekjes së dikujt flitet me ndjenjë të thellë për cilësitë e mira të tij, e njëjtë më *sagu*-në (elegjinë) e letërsisë paraislame turke dhe *ağit*-in (këngë vaji) e letërsisë popullore turke. Mersijet e shkruara për njerëz të veçantë ndahen në mersije për padishahët, princat, vezirët dhe funksionarët e tjerë, personalitet fetare dhe për shokët e të afërmit. Në këtë ndarje, mersijet e Qerbelasë mund të klasifikohen si mersije për personalitetet e fesë. Megjithatë, po të merren parasysht disa aspekte të tyre, në këtë ndarje mersijet e Qerbelasë mund të shqyrtohen si një grup më vete.

Për nga sasia, mersijet e Qerbelasë janë më të shumta se mersijet e të gjitha grupeve të tjera të marra së bashku. Në letërsinë turke, teksa mersijet e shkruara për persona (litete) të tjerë janë rreth 130, mersijet e Qerbelasë janë rreth 400. Mersijet për njerëzit e tjerë janë shkruar e shumta deri disa vite pas vdekjes së tyre, kurse mersijet e Qerbelasë shkruhen që nga koha e martirizimit të Hz. Hysejnit e deri në ditët tona.

Teksa mersijet e tjera janë shkruar vetëm në gjuhën e vet nga poetët e kombit përkatës të personit të vdekur, mersijet e

Qerbelasë janë shkruar nga poetët arabë, iranianë dhe turq. Nga kjo pikëpamje konsiderohen si një vepër e përbashkët e botës islame.

Për sa i përket përmbajtjes, mersijet fillojnë me fajësimin e fatit, përkohësinë e kësaj bote, duke vazhduar më tej me përshkrimin e ngjarjes, lavdërimet, vajtimin (mbajtja zi) dhe lutjet e përgjërimit. Edhe pse përbëhen nga të njëjtat pjesë si mersijet e tjera, mersijet e Qerbelasë kanë disa aspekte të veçanta. Duke menduar se ka kaluar kohë e gjatë që nga ngjarja dhe se lexuesit mund të mos kenë marrë dot të dhëna të hollësishme për ngjarjen, më shumë vend i jepet përshkrimit të ngjarjes. Në mersijet e tjera, sipas shkakut të vdekjes nuk u thuhet drejtpërdrejt ndonjë gjë shkaktarëve po fajësohet fati, kurse në mersijet e Qerbelasë në çdo rast thuhet se fajtor është Jezidi dhe fajësimi i fatit zë pak vend.

Te mersijet e tjera, në pjesën e lutjeve dhe përgjërimeve bëhet lutje që vendi i të vdekurit të jetë parajsja dhe që të afërmit të kenë shëndet dhe durim, te mersijet e Qerbelasë, në pjesën e lutjeve, poetët më shumë tregojnë për shkakun e shkrimit të poezisë dhe luten që Hz. Hysejini të jetë ndërmjetës për ta. Poeteshat në mënyrë të veçantë kërkojnë ndërmjetësim (shefa'at) nga Hz. Fatma. Në mersijet e Qerbelasë, në fund të lutjes çdo herë mallkohet Jezidi dhe bashkëpunëtorët e tij. Poetët e dinë se sipas traditës islame nuk është mirë që të përmenden anët e këqija të të vdekurve, por për Jezidin thonë se duhet mallkuar patjetër. Madje Zija Pashai thotë se kjo gjë është obligim:

*“Kemine bende-i Al-i Abayuz kavm-i Sufyana / Ne jemi sklllevërit e gjorë të familjes së Profetit*

*Demadem lanet etmek farzdir hem farz-i akdemdir”/ Obligimi ynë kryesor është të mallkojmë popullin e Sufjanit.*

Mersijet e Qerbelasë, ashtu siç janë motiv (çështje) i përbashkët i botës islame, ashtu janë edhe motiv i përbashkët i letërsisë së divanit, letërsisë së teqeve dhe letërsisë popullore në letërsinë turke. Shembujt e parë të mersijeve të Qerbelasë në letërsinë turke fillojnë që në shekullin XV. Proza e rimuar që përfshihet në veprën “Tazarrunname” të Sinan Pashait, është i vetmi shembull i këtij lloji. Në të njëjtin shekull, mersija e përfshirë në veprën “Muhamedije” të Yazıcıoğlu Mehmedit është e para mersije e

shkruar me metrin e *aruz*-it (prozodi-metër i letërsisë së divanit i përbërë nga kallëpe vokale që kanë si bazë gjatësinë dhe tonin e rrokjeve), ndërsa mersija e divanit të Ashik Junusit është e para mersije e shkruar me metrin e *hexhe*-s (metër që ka si bazë numrin e rrokjeve). Paskësaj poetët e letërsisë turke që kanë shkruar mersije të Qerbelasë me metrin e aruzit, janë:

Në shek. XVI: Hajretiu, Fuzuliu, Ubejdju, Shemsi Pashai, Safiu.

Në shek. XVII: Sejjid Sejfullah Ibn-i Nizameddini, Aliu prej Gelibolluje (Gelibolulu Ali), Ruhiu prej Bagdati (Bagdatli Ruhi), Kafzade Faiziu, Arshiu, Sabri Mehmed Sherifi, Fehm-i Kadimi, Dede Sabuhi Shejh Ahmedi, Feriduni, Xhemiu, Nailiu, Dede Fasih Ahmedi.

Në shek. XVIII: Dede Birri Mehmedi, Kamiu prej Edirneje (Edirneli Kami), Jahja Nazimi, Beligu, Sezayi-i Gylsheniu, Xhemaliu, Lejla Hanëmi, Nevres-i Kadimi, Behishtiu, Sykutiu, Zyhdiu, Hashim Efendiu.

Në shek. XIX: Neshet Efendiu, Dede Zekajiu, Selamiu, Refi-i Kallajiu, Keçixhizade Izzeti, Baba Myshtaku, Mehmed Shakir Efendiu, Mehmed Emin Iffeti, Muharrem Efendiu, Sheref Hanëmi, Zahmiu, Kami-i Amidiu, Ijdi Haxhi Mehmedi, Senihiu, Lebibi, Turabiu, Galibi prej Nikozie (Lefkoşalı Galib), Zija Pashai, Avniu prej Jenishehiri (Yenisehirli Avni), Xhejhuniu, Kazim Pashai, Mebniu, Hoxhazade Ahmed Kamili, Kemteriu, Adile Sulltani, Hakki Beu, Kazim Ibrahim Çelebiu, Ed'hemi, Osman Shemsiu, Molla Muradi, Gedaiu, Ibreti, Dyrriu, Shirzadi, Xhaferiu, Izzetiu, Zihni-i Kilisiu, Nazifi, Necmiu, Tahiri, Hajdar El-Kejali Er-Rufaiu, Kemaeddin Muhammed Kemahiu, Figaniu, Mustafa Eshref Pashai.

Në shek. XX: Arif Hikmeti prej Hercegovine (Hersekli Arif Hikmet), Ali Ferruhi, Mehmed Ali Hilmiu, Mual-lim Fejziu, Ibrahim Hakki Kemahiu, Edib Harabiu, Murad Emriu, Mehmed Shevketi, Mehmed Memduh Pashai, Hivziu, Sidkiu, Abdulmalik Hilmiu, Kanballakzade Hazmiu, Fahimiu, Shemseddin Misriu,

Ahmed Remziu, Isjaniu, Tahir Ollguni, Jusuf Fahiri, Hadiu, Sofuzade Tevfiku, Jesariu, Xhudiu, Muhammed Lytfiu.

Kurse poetët e letërsisë turke që kanë shkruar mersije të Qerbelasë me metrin e hedhes, janë:

Në shek. XVI: Pir Sulltan Abdalli.

Në shek. XVII: Dedemoglu.

Në shek. XVIII: Kalbiu, Baba Noksaniu.

Në shek. XIX: Miratiu, Deli Borani.

Në shek. XX: Baba Sidkiu, Hyzniu prej Jozgati (Yozgatli Huzni), Baba Hilaliu, Hysejin Çirakmani, Fakiriu, Sefil Aliu, Done Sullatni, Dede Sejjahu, Rizai, Arif Abdalli, Dervish Kemali.

Nga letërsia e Azerbajxhanit, poetët që kanë shkruar mersije të Qerbelasë, janë: Raxhiu, Dehili, Pyrgemi, Shuaiu, Kudsiu, Kasimbej Zakiri, Hurshid Banu Natevani, Mirze Ismajil Gasiri, Mirze Aliekber Sabiri.

Mendimi se hidhërimi për ngjarjen e Qerbelasë, zakonet e traditat dhe veprat letrare në lidhje me të i përkasin grupeve shiite ose të ndikuara prej shpitëve, nuk është i drejtë. Kur shqyrtohen poetët që kanë shkruar këto mersije, shohim se ata u përkasin të gjitha shtresave (shtresave të ndryshme). Nganjëherë, të shkruarit e poezive për këtë ngjarje prej njerëzve që nuk kanë shumë njohuri në lidhje me këtë çështje, mund të shihet si tendencë shiite (anim për kah shiizmi). Mersije të Qerbelasë kanë shkruar madje edhe poetë mistikë të rangut të lartë të tarikateve të ndryshme, sidomos të tarikatit mevlevi.

Si përfundim, ngjarja e Qerbelasë është një ngjarje e dhimbshme që vazhdon të trishtëjë të gjithë muslimanët. Çdo vend ka zakone dhe tradita specifike që kanë rrjedhur nga dhimbja e kësaj ngjarjeje (që e kanë burimin nga kjo ngjarje). Në lidhje me të janë krijuar vepra të shumta në fushën e arkitekturës, teatrit, muzikës, pikturës, miniaturës dhe, në mënyrë të veçantë, në fushën e letërsisë. Këto

veprimtari dhe vepra janë pasqyrim i dhimbjes së përbashkët që ndihet për shkak të ngjarjes së Qerbelasë dhe ndryshimet ndërmjet tyre duhet t'i shohim si larmi e mozaikut kulturor.

Në mbështetje të pikëpamjes sonë, mund të japim si shembull mersijen e Qerbelasë të shkruar nga Ashik Junusi në shek. XV, një elegji e njohur dhe e pëlqyer nga të gjithë:

*Şhidlerin ser-çeşmesi / Më të rëndësishmit nga dëshmorët  
Hasanula Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini  
Aşıkların gözi yaşı / Lotët që derdhin të dashuruarit  
Hasanula Hüseyindir / Janë (për) Hasanin dhe Hysejinin*

*Hazret-i Ali babaları / Hz. Ali është i ati  
Muhammeddir dedeleri / Muhammedi është gjyshi i tyre  
Arşun iki küpeleri / Dy vathët e qiellit  
Hasanula Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini*

*Dedesiyle bile varan / Ata që shkojnë me gjyshin  
Keşser irmağında duran / Ata që ndalojnë në përroin e Kevtherit  
Susuz ümmete su viren / Ata që u japin ujë ymetit të etur  
Hasanula Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini*

*Kerbelada yazuları / Kaderi i tyre është Qerbelaja  
Şhid oldı gazileri / Ushtarët e tyre ranë dëshmorë  
Fatma Ana kuzuları / Qingjat e mëmë Fatmes  
Hasanula Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini*

*Ayet içinde okınan / Ata lexohen nëpër ajete  
Şhidlere ser-dar olan / Ata që ishin komandantë të dëshmorëve  
Cennet içinde salınan / Ata që ecën me krenari në Parajsë  
Hasanula Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini*

*Kerbelaya aşırđılar / Ata që u dërguan në Qerbela  
Akılçığın şaşıldılar / Ata që u marrosën pamasë  
Kol ağun düşürdüler / Atyre që iu prenë krahët  
Hasanula Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini  
Kerbelanın ta içinde / Që nga brenda Qerbelasë*

*Nur akar siyah saçında / Zbret një nur në flokët e zinj  
Yatan al kanlar içinde / Ata që dergjen në gjakun e kuq  
Hasanıla Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini*

*Yunus Emrem dünya fani / Ej, Junus Emre, bota është e përkohshme  
Terk eyle gel can u teni / Eja dhe braktise shpirtin  
İki cihanın sultanı / Sepse mbretërit e të dy botëve  
Hasanıla Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini*

*Yunus Emrem ben de bulam / Ej, Junus Emre, edhe unë e di  
Bu dünyanın sonu viran / Fundi i kësaj bote do të jetë shkatërrimi  
Kerbela da şehid olan / Ata që ranë dëshmorë në Qerbela  
Hasanıla Hüseyindir / Janë Hasani dhe Hysejini.*

### **Bibliografia:**

1. GÜNGÖR, Şeyma, Fuzuli'nin Hadikatü's-Süeda'sı, Ankara, 1987
2. İSEN, Mustafa, Acıyı Bal Eylemek, Türk Edebiyatında Mersiye, Ankara, 1993
3. AHMET CEVDET, Kısas-ı Enbiya ve Tevarih- Hulefa (Hazırlayan: Fahir İz) İstanbul, 1972
4. OLGUN, Tahir, "Muharrem ve Matem", Mahfil, Muharrem, 1340, cilt 2, sayı 15 sayfa 55-56
5. ERÖZ, Mehmet, Türkiye'de Alevilik Bektaşilik, Ankara, 1990
6. NOYAN, Bedri, "Bektaşî ve Alevilerde Muharrem Ayini, Aşure ve Matem Erkanı" Halk Kültürü, İstanbul, 1984, s. 82
7. AND, Metin, "İslam Folklorunda Muharrem ve Taziye" Türk Folkloru Araştırmaları Yıllığı, 1976, Ankara, 1987, sayı 3, s. 4
8. AND, Metin, "Muharrem Törenleri ve Sanat: Drama Dönüşen Ritüeller, Danslar ve Sözlü Edebiyat Gelenekleri", Milliyet Sanat, Aralık, 1978, sayı 303, s. 16
9. AND, Metin, "Eski Edebiyatımızda Yarı Dramatik Bir Tür: Maktel ve Minyatürlü Maktel Yazmaları" Türkiyemiz, Haziran, 1990, cilt 20 sayı 61, s. 4-15
10. FIĞLALI, Ethem Ruhi, Türkiye'de Alevilik Bektaşilik, Ankara, 1990

11. KARAHAN, Abdulkadir, Anadolu Türk Edebiyatında Maktel-i Hüseyin, Türkoloji Bitirme Tezi, 1938-39, İstanbul Üniversitesi, Tez No: 443
12. MEVLANA, Celaleddin Rumi, Divan-ı Kebir (hazırlayan: Abdülbaki Gölpınarlı), Eskişehir, 1992
13. KÜLTÜR BAKANLIĞI, Türkiye Dışındaki Türk Edebiyatları Antolojisi, Ankara, 1993
14. MENĞİ, Mine, "Eski Türk Edebiyatını Mersiyelerine Toplu Bir Bakış" Ege Üniversitesi Türk Dili ve Edebiyatı Dergisi, İzmir, 1983
15. GÖÇGÜN, Önder, Ziya Paşa'nın Hayatı Eserleri ve Bütün Şiirleri, Ankara, 1987
16. TATÇI, Mustafa, Aşık Yunus ve Diğer Yunusların Şiirleri, Ankara, 1991
17. ERGÜN, Saadettin Nüzhet, Alevi Bektaşî Kızılbaş Şairler ve Nefesleri, İstanbul, 1956
18. ELÇİN, Şükrü, Ağıtlar, Ankara, 1990
19. PAKALIN, Mehmet Zeki, Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü, Ankara, 1983 (Mersiye ve mersiyehan maddesi)
20. ÇAĞLAYAN, Bünyamin, Kerbelâ Mersiyeleri, Gazi Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Eski Türk Edebiyatı Bilim Dalı Doktora Tezi, Ankara, 1997.